
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 06.11.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE APARATURA DHE PAISJE TEKNOLOGJIKE
PROFESIONALE PËR LABORATORIN E ANALIZAVE KIMIKE TË SHËRBIMIT
GJEOLOGJIK SHQIPTAR PËR VITIN 2025”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Aparate
analizues- 38432000-2, Spektrometra- 38433000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,333,333 (tre milion e treqind tridhjetë e tre mijë e treqind e
tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në
rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e
specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen
si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari
përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për
Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së
Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82,

i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se

operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet : c) 40 % vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme .”

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 55 pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 55 pika 4/b VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme çka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e vet të paktën 1 (një) specialist në profilet: Kimi e përgjithshme / Kimi Industriale / Bioteknologji të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve:

- Diplomë në fushat përkatëse,
- Kontratës individuale të punës

Shënim: Ky kriter (2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c dhe të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”.

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi. Duke konsiderur rendesine e analizave që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është vlerësuar e domosdoshme kërkesa për specialist fushë të cilin zoteron njohuritë e nevojshme mbi keto mallra dhe garanton AK në zbatimin e kontratës sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Sipas specifikimeve teknike, pajisjet të cilat do të shpërndahen me të gjithë aksesoret e nevojshëm për instalimin dhe vënien në punë të tyre. Pra kërkesa për këtë specialisht është vendosur, pasi disa nga artikujt janë të shpërndajura me aksesore përkatës të cilat duhet të vendosen në punë nga një specialist i operatorit ekonomik fitues.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike për mallin objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit. Nëse katalogu/ët/ skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shpërndahen nga një përkthim i notëzuar në shqip.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që artikujt e ofruar i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, funksioni që ata kryejnë, kryerja e analizave për prodhimin e ujit ASTM Tip I, për matjet të ndjeshme të analizave të ujit të pijshëm siç janë, pH konduktiviteti etj dhe disa nga indekset kryesore të parametrave të ujit, është e rëndësishme kërkesa për katalog /skedë teknike të

prodhuesit. Gjithashtu këto dokumenta janë të domosdoshme për marrjen në dorëzim të mallit për autoritetin kontraktor.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për mallrat objekt prokurimi, ku të plotësohen referenca e të dhënave teknike të mallrave të ofruara në formë tabele si më poshtë:

Emërtimi i mallit	Emri, Adresa, Website të Kompanisë Prodhuese ose Distributorit të Autorizuar	Emri Katallogut, Skedes teknike	Nr. Faqes Katallogut, Skedes teknike	Nr. Identifikues i Produktit
-------------------	--	---------------------------------	--------------------------------------	------------------------------

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*. Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e të dhënave së mallit si, kompaninë prodhuese ose distributorin e autorizuar, emrin e katalogut/ skedës teknike, numrin e faqes se tyre dhe numrin identifikues të produktit, për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Gjithashtu këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës, pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatë CE ose ekuivalente e saj, si dhe të deklarojë se në momentin e dorëzimit, pajisja do të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC/ Certifikatë CE ose ekuivalente e saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, neneve 8, 9,10,11 dhe 12 i ligjit nr. 10489 date 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, nenin 40 pika 8 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Deklarata nga operatori ekonomik se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente e saj dhe në momentin e dorëzimit të pajisjes në Autoritetin Kontraktor përfitues pajisja të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente e saj, kërkohet për të demonstruar përmbushjen e kërkesave për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshire dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën minimale 2 (dy) vite të garancisë së mallit objekt prokurimi, nga dita e vënies në punë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor përfitues që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi I specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga strukturat e posaçme pranë autoritetit kontraktor përfitues Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr.

285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike të paisjeve janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Shërbimi Gjeologjik Shqiptar si mëposhtë:

1. Pajisja (Dejonizuesi, për prodhimin e ujit ASTM Tip I).

- Metoda e purifikimit të ujit: Adsorbim me anë të karbonit aktiv, katalizatorit, osmoze reverse, jonokëmbimit, rrezatimit UV
- Tipi i ujit të prodhuar: Type I
- Konduktiviteti tipik: 0.055µS/cm
- Rezistenca 18.2 MΩ x cm

- Temperatura nga 2-40°C
- TOC ≤ 5 ppb
- Bacteria < 0.01 CFU/ml
- Me depozitë jo me pak se 5 litra.
- Me llampë UV
- Parametrat e ujit të shfaqen në ekran.
- Pajisja të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm për instalimin dhe vënien në punë, si dhe material konsumi (Filtrat), minimalisht për 1 vite pune.

2. Spektrofotometer UV/VIS

- I optimizuar për matjet ë ndjeshme për analiza uji të pijshem.
- Të jetë i programuar për më shumë se 180 teste reagentesh.
- Të masë në UV në gjatesi vale (190-320 nm) dhe VIS (320-1100 nm)
- Të jetë i paisur me llampë ksenon flash ose deuterium llamp.
- Mundësi për shtim metodash
- Të jetë i përshtatshëm për kyveta 10, 20 ,40, 50 mm dhe kyveta rrethore 16 mm AD
- Të jetë i aftë për zbulim automatic të metodës së testimit përmes kodit
- Perditesim automatik per kalibrim.
- Kalibrimi i gjatesisë vales automatike dhe manual.
- Paisja të ruajë analizat e testuara dhe ti shfaq në ekran.
- Të jetë i mbrojtur nga drita ambientale.
- Te jete rezistent ndaj kimikateve te perdorura ne analizat e ujit.

3. Pajisja për prodhimin e ujit te bidistiluar.

Uji i bidistiluar duhet të jetë me cilësi shumë të lartë, me përçueshmëri të ulët

- Konduktiviteti tipik: < 2 $\mu\text{S}/\text{cm}$ (idealisht 0.1-1.5 $\mu\text{S}/\text{cm}$ për analiza shumë sensistive)
- pH i ujit 5.5-7.5
- pa klor, minerale apo baktere
- Materiali te jetë çelik inoks rezistent ndaj korrozionit
- Kapaciteti i prodhimit 5-10 litra ne orë
- Kontrolli të jetë automatik me pompë të integruar dhe alarm për ndërprerje të energjisë
- Pjesë që kontaktojnë ujin të jene metal ose qelq i pastër jo plastike që mund të lëshojnë jone
- Me depozitë te ujit te filtruar jo me pak se 30 litra.
- Perdor uje rrjeti me presion 0.5-6 bar.
- Parametrat e ujit të shfaqen në ekran.
- Pajisja të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm për instalimin dhe vënien në punë.

4. Specifikimet: Multiparameter me 3 kanale (pajisja me 3 elektroda)

- **Elektroda pH – metri.**

Parametrat qe mat elektoda: pH ($-\log [H^+]$), potenciali elektrodik (mv), temperatura

Zona e matjes: -2.00 deri ne + 20.00

Saktesia e matjes se pH: ± 0.01 njesi pH.

Leximi i matjes se pH: ± 0.01 njesi pH.

Temperatura e matjes: - 5 deri ne 105 grade Celsius

Pikat e kalibrimit: Minimumi 3 tretesira buferike kalibruese dhe te njohe automatikisht 16 bufera te ndryshem.

Kompesimi automatik i temperatures ndaj temperatures referuese 25 °C.

Korrektimi automatik i pjerresise se electrodes te jete nga 90-105 %.

Elektroda te jete qelqi me sensor temperature, i mbushur me solucion KCl.

Zona e matjes se potencialit: nga -1800 deri ne +1800 mV

- **Elektrode konduktiviteti**

Parametrat qe mate elektroda: Percjellshmeria elektrike ($\mu\text{S}/\text{cm}$ ose mS/cm), Temperature °C.

Zona e matjes se percjellshmerise: 1 $\mu\text{S}/\text{cm}$ deri ne 2 S/cm

Zona e matjes se temperatures: - 5 deri ne ± 80 °C

Saktesia e matjes se percjellshmerise: ± 0.5 % per kompesimin e temperatures.

Korrigjimi i temperatures te jete automatik

Konstatntja e celules te jete: $0.475 \text{ cm}^{-1} \pm 1.5\%$

Elektoda te jete prej grafiti me sensor te integruar te temperatures.

- **Elektrode per DO**

Zona e matjes: ne temperature 20° C: 0- 20 mg/l DO $\pm 0.5\%$ te vleres.

Saturimi: 0- 200% $\pm 0.5\%$ te vleres.

Temperature e matjes: 0- 50° C ± 0.2 °C

Saktesia e matjes: ± 1.5 %

Materiali te jetë kundër lageshtisë me konektor dixhital me sensor optik.

Garancia e pajisjeve teknologjike duhet të jetë 2 vite, nga data e vënies në punë.

NJËSIA E PROKURIMIT